



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**MINISTRIA E FINANCAVE DHE
EKONOMISË
DREJTORIA E PËRGJITHSHME E
DOGANAVE**

Nr. 14365 prot.
Tiranë, më 19.06.2018

**MINISTRIA E FINANCAVE DHE
EKONOMISË
DREJTORIA E PËRGJITHSHME E
TATIMEVE**

Nr. 12819 prot.
Tiranë, më 19.6.2018

MARRËVESHJE BASHKËPUNIMI

NDËRMJET

DREJTORISË SË PËRGJITHSHME TË DOGANAVE

DHE

DREJTORISË SË PËRGJITHSHME TË TATIMEVE

Mbështetur në Legjislacionin Doganor dhe Tatimor në fuqi, Kodin Doganor të Republikës së Shqipërisë, Ligjin Nr.9920, datë 19.05.2008 "Për Procedurat Tatimore në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar, Ligjin Nr.92/2014, "Për Tatimin mbi Vlerën e Shtuar", dhe aktet nënligjore në zbatim të tyre,

Drejtoria e Përgjithshme e Doganave (në vijim DPD), institucion nën varësinë e Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë, e përfaqësuar nga Znj. Belinda Ikonimi Drejtor i Përgjithshëm,

dhe

Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve (në vijim DPT), institucion nën varësinë e Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë, e përfaqësuar nga Znj. Vasilika Vjero, Drejtor i Përgjithshëm,

Në vijim Palët,

Duke marrë në konsideratë,

Rritjen e kapaciteve teknike në fushën e dixhitalizimit;

Krijimin e lehtësirave për biznesin;

Nevojën për të garantuar mbledhjen e të ardhurave tatimore dhe doganore në Republikën e Shqipërisë, shmangien e abuzimeve dhe parandalimin e evazionit fiskal;

Me synim që, veprimtaria e shërbimit tatimor dhe doganor të sigurojë një performancë të lartë, të vendosur mbi baza metodike dhe normative që i korrespondojnë standardeve më të përparuara, të cilat kërkojnë realizimin e shkëmbimit të informacionit në mënyrën sa më të shpejtë dhe efikase; dhe

Me synim, forcimin e mbikëqyrjes dhe kontrollit mbi veprimtarinë e tatimpaguesve/operatorëve ekonomike,

Bien dakord si më poshtë:

Neni 1

Qëllimi

Qëllimi i kësaj Marrëveshjeje është bashkërendimi i veprimeve, sigurimi dhe shkëmbimi informacionit, përfshirë atë në kohë reale, si dhe mbështetja reciproke për të parandaluar dhe luftuar evazionin fiskal dhe aktivitete të tjera të paligjshme, në funksion të përmirësimit të administrimit tatimor dhe doganor, me synim rritjen e performancës për mbledhjen e të ardhurave tatimore dhe doganore dhe garantimin e veprimtarisë së operatorëve ekonomikë nëpërmjet uljes së kohës së procedurave të shërbimit, kontrollit dhe kostove respektive.

Neni 2

Format e bashkëpunimit

1. DPD dhe DPT:

- a. shkëmbejnë information në kohë reale dhe në mënyrë periodike në rrugë elektronike duke parashtruar procedurat që do të udhëheqin procesin e transmetimit të të dhënave, si dhe të shkëmbimit të informacionit ndërmjet palëve.
- b. shkëmbejnë informacion në mënyrë periodike dhe/ose me kërkesë, në rrugë elektronike dhe/ose me shkresë zyrtare,
- c. miratojnë programe dhe realizojnë hetime dhe/ose kontrole të përbashkëta, bazuar në metodikën e analizës së riskut dhe/ose informacioneve lidhur me rastet e mundshme të evazionit fiskal.
- d. kryejnë veprime të përbashkëta lidhur me vjeljen apo mbledhjen e borxhit ose detyrimeve të papaguara nga tatimpaguesit/operatorët ekonomike.
- e. kryejnë trajnime për personet respektive për mënyrën e funksionimit të sistemeve, të bazave të të dhënave apo të raporteve të ndërtuara paraprakisht.

Neni 3 Shkëmbimi i informacionit

1. Palët respektivisht sipas fushave të ligjit të zbatueshëm prej tyre, do të mundësojnë shkëmbimin e të dhënave në kohë reale midis sistemeve respektive përsa i përket të dhënave të cilat ndikojnë në punën drejtpërdrejtë apo në mënyrë të tërthortë me mbledhjen e të ardhurave tatimore dhe doganore si dhe me parandalimin e evazionit fiskal dhe aktivitetet e tjera të paligjshme nëpërmjet zhvillimit të analizave të riskut.
2. Mënyra e shkëmbimit të të dhënave midis dy institucioneve kryhet sipas hapave të detajuara në Protokollin e Shkëmbimit Elektronik, që është pjesë përbërëse e kësaj Marrëveshjeje. Protokollin e Shkëmbimit Elektronik është një dokument i cili mund të përditësohet me aprovim të palëve. Ky përditësim mbulon edhe përfshirjen anekseve në Protokollin e Shkëmbimit Elektronik.
3. Në rast se informacioni nuk është i aksesueshëm në kohë reale, palët kërkojnë dhe shkëmbejnë informacion në rrugë elektronike dhe/ose me shkresë zyrtare.
4. Palët përcaktojnë personat e kontaktit sipas funksioneve që kryejnë, të cilët komunikojnë në rrugë elektronike (e-mail) me qëllim konsultimi teknik dhe shkëmbim informacioni në raste specifike dhe/ose urgjente. Personat e kontaktit do të kenë akses në sistemet reciproke të të dy institucioneve.
5. Informacioni që shkëmbehet apo kërkohet është, si më poshtë:
 - a. Informacion i shkëmbyer *në kohë reale/periodikisht në mënyrë elektronike* nga DPD në DPT përfshin:
 - i. të dhënat e import-eksporteve të kryer nga operatorët ekonomik dhe individët, ku të specifikohet saktë origjina e mallit, emërtimi i artikujve dhe sasia për çdo njësi;
 - ii. ndryshimet në kodet e procedurës së zgjeruar dhe në kodet e marrëveshjeve përkatësisht kutia 37a dhe 37b të DAV (Deklaratës Doganore);
 - iii. informacion mbi rivlerësimet e deklarave doganore;
 - iv. listën e tatimpaguesve debitorë në administratën doganore për të cilët është lëshuar Urdhër ekzekutimi nga Gjykata, me qëllim zbatimin e Urdhërit nga administrata tatimore;
 - v. listën e tatimpaguesve për të cilët janë hequr masat e parashikuara në pikën "iv", më sipër;
 - vi. subjektin/subjektet për të cilët është aplikuar masa në gërmën b, pikat "ii" dhe "iii";
 - vii. çdo informacion tjetër siç parashikohet në akte ligjore dhe nënligjore.
 - b. Informacion i shkëmbyer *në kohë reale/periodikisht në mënyrë elektronike* nga DPT në DPD përfshin:
 - i. regjistrin e subjekteve aktive të regjistruar në regjistrin e administratës tatimore;
 - ii. subjektet me status pasiv në regjistrin e Administratës Tatimore, me qëllim bllokim të mallit për qarkullim të lirë;
 - iii. lista e tatimpaguesve debitorë për të cilët është lëshuar Masë sigurimi e detyrimit tatimor nga administrata tatimore, me qëllim bllokimin e mallit për qarkullim të lirë;
 - iv. lista e tatimpaguesve për të cilat janë hequr masat e parashikuara në pikat "ii" dhe "iii", më sipër;
 - v. subjektin/subjektet për të cilët është aplikuar masa në gërmën "a" pika "iv";
 - vi. çdo informacion tjetër siç parashikohet në aktet ligjore dhe nënligjore.
 - c. Informacion i shkëmbyer *sipas kërkesës në formë shkresore/electronike për raste specifike*:
 - i. situatën financiare të subjektit të deklaruar në Sistemin Informatik të Tatimeve dhe të dhënat e deklaruar në librat e shitjes dhe të blerjes;
 - ii. adresën/at e selisë/ve kryesore dhe adresën/at e tjera sekondare të subjekteve;

- iii. numrat serial të blloqeve të faturave tatimore të shitjes të TVSH-së, të faturave të shoqërimit apo faturave të thjeshta të shitjes (Model 4) të tërhequra nga tatimpagues/operator ekonomik të Akcizës;
- iv. borxhin e akcizës për tatimpaguesit/operatorët ekonomikë;
- v. detyrime tatimore dhe doganore të papaguara të tatimpaguesve/operatorëve ekonomikë,
- vi. TVSH e kërkuar për rimbursim;
- vii. shkelje të konstatuara nga kontrollet në fushën e ligjit për Akcizën;
- viii. shkelje të konstatuara nga kontrollet në fushën e ligjit për TVSH-në;
- ix. shkelje të konstatuara nga kontrollet doganore sidomos në magazinat doganore ose të lira;
- x. shkelje të konstatuara nga kontrollet në fushën e ligjit për Taksat Kombëtare;
- xi. informacion lidhur me vendimet gjyqësore të formës së prerë me impakt në aktivitetin e Palëve (referencat) për të evituar abuzimet ose deklaratimet e dyfishta;
- xii. informacioni që disponohet nga Palët mbi numrat e llogarive bankare të subjekteve;
- xiii. të dhënat për subjektet në regjim përpunimi aktiv (fason): si gjendjen inventariale të mallrave për një periudhë të caktuar, vlera, etj që disponohen në kuadër të regjimit;
- xiv. informacion i kërkuar për raste të mospërputhjes së të dhënave doganore apo tatimore;
- xv. çmimet e referencës të aplikuara në doganë;
- xvi. gjendjet e mallrave në magazinat doganore në një moment të caktuar;
- xvii. çdo informacion tjetër siç parashikohet në aktet ligjore dhe nënligjore.
- d. Gjithashtu pala, respektivisht sipas fushave të ligjit të zbatueshëm prej tyre, do të shkëmbejnë informacion periodik, në rrugë elektronike dhe/ose shkresore, përsa i perket:
- e. aplikimit të skemave të shtyrjes apo përjashtimit të TVSH, në zbatim të legjislacionit në fuqi, përfshirë të dhëna për TVSH-në e shtyrë në doganë në rastin kur janë tejkaluar afatet ligjore të pagesës;
- f. rimbursimeve të akcizës;
- g. lista e subjekteve të akcizës dhe xhiro vjetore e tyre;
- h. informacion mbi subjektet që paraqesin risk të lartë për shkelje në fushën tatimore dhe doganore.
- 6. Shkëmbimi i informacionit, në rastet e parashikuara kështu në këtë marrëveshje, bëhet sipas Anekseve bashkëlidhur, pjesë e kësaj Marrëveshjeje dhe sipas rregullave të mëposhtme:
 - a. Në këto Aneksë përcaktohen detaje teknike, periodiciteti, mënyra e shkëmbimit të informacionit dhe të dhënat e tjera të nevojshme që kanë të bëjnë me sigurinë e sistemeve informatike të Palëve dhe bashkëpunimit në këtë fushë.
 - b. Nëse nuk është i mundur realizimi i shkëmbimit të informacionit në përputhje me pikën e mësipërme, këto të dhëna dërgohen në rrugë shkresore dhe/ose CD.
 - c. Palët shkëmbejnë në rrugë shkresore dhe elektronike emrat e kontaktit dhe të dhënat e tyre (tel., e-mail, etj), për secilën fushë të bashkëpunimit. Edhe ndryshimi i personave të kontaktit bëhet me shkresë zyrtare, në afatin më të shpejtë të mundshëm.
 - d. Kur informacionet kërkojnë urgjent, personat e kontaktit, pas miratimit nga drejtuesit përkatës, mundet t'a dërgojnë paraprakisht me e-mail informacionin e kërkuar. Më pas, nëse nevojitet, mund të procedohet me formë shkresore.
- 7. Palët duhet t'u përgjigjen njëra-tjetrës për kërkesat respektive sa më shpejt të jetë e mundur, por në çdo rast brenda një afati kohor prej jo më shumë se 15 (pesëmbëdhjetë) ditësh kalendarike nga data e marrjes dijeni për kërkesën.
- 8. Organet në varësi të Palëve në raste të veçanta, mund të shkëmbejnë informacionin e parashikuar në këtë marrëveshje.

Neni 4

Bashkëpunimi në fushën e akcizës

1. Administrata tatimore i krijon akses në sistemin NEXUS për të dhënat e karburanteve/gazit Drejtorisë së Kontrollit dhe Metodikave në Departamentin e Akcizës, për të krijuar analiza rixu për kontrolle në këtë fushë.
2. Një herë në vit, të dy palët organizojnë kontrolle të përbashkëta në fushën e hidrokarbureve, Prodhuesve të Mëdhenj të Birrës dhe gjithë importuesve të cigareve në bazë të Planit të punës që do të vendoset me Urdhër të dy Drejtorëve të Përgjithshëm brenda muajit Janar të çdo viti.
3. Brenda datës 10 të çdo muaji, Administrata doganore dërgon raporte periodike me subjektet dhe kodet e produkteve të akcizës të cilët kanë rezultuar me renie në sasi, çmim, vlerë, akcizë, etj.; Administrata tatimore informon për analizat dhe konkluzionet e tyre lidhur me raportet.
4. Çdo kontroll tek operatorët ekonomikë, i kryer nga strukturat e akcizës në të cilin ka rezultuar me shkelje në fushën e akcizës, i përcillet DPT për verifikime të mëtejshme. Për rezultatet e verifikimeve, duhet të njoftohet njësia përkatëse në Departamentin e Akcizës.
5. Palët në rastin kur e gjykojnë të arsyeshme se nevojiten kontrolle të përbashkëta sidomos tek tatimpaguesit/operatorët ekonomike subjekte të ligjit për Akcizën, njoftojnë njëra-tjetrën respektivisht se kërkohet një veprim i tillë dhe propozojnë programin e përbashkët të kontrollit dhe punonjësit, që do të kryejnë kontrollet, të cilat autorizohen/miratoohen përkatësisht nga titullarët e palëve.
6. Në këtë rast pala që programon kontrollin sipas fushës së administrimit, njofton palën tjetër, e cila nëse e gjykon të nevojshme që në të njëjtën periudhë të kryejë kontroll për të njëjtin subjekt, njofton brenda 7 ditësh kalendarike palën që i ka derguar njoftimin sipas rastit. Rolin koordinues dhe kryesues për këto kontrolle e ka Pala, e cila inicion këtë procedurë.
7. Në përfundim të kontrolleve të pavarura ose të përbashkëta, kur palët konstatojnë shkelje, të cilat kanë pasoja në llogaritjen e detyrimeve tatimore, doganore ose të tjera, përveç se njoftojnë respektivisht njëra-tjetrën mbi rezultatet e kontrollit, nxjerrin akte të veçanta në përputhje me legjislacionin e fushës së administruar nga Pala.

Neni 5

Hetimi i përbashkët tatime-dogana

1. Nëse struktura e hetimit të njëres palë kërkon bashkëpunim të strukturave të hetimit të palës tjetër, atëherë duhet të inicojë hetime zyrtare që kanë të bëjnë me veprime të cilat paraqiten ose janë në kundërshtim me legjislacionin përkatës tatimor dhe/ose doganor në fuqi në Republikën e Shqipërisë si psh. përdorimi i mallrave pa faturë, mallrat pa pullë fiskale si dhe veprime të tjera të kundërligjshme sidomos në territoret pranë ose jashtë degëve doganore.
2. Pas përfundimit të hetimit, administrata përkatëse, duhet të komunikojë rezultatin e hetimit në vëmendje të administratës tjetër kërkuese pa ndonjë vonesë. Hetime të tilla duhet të kryhen sipas legjislacionit në fuqi përkatës.
3. Me kërkesë, struktura e hetimit e administratës kërkuese mund, në raste specifike si psh kontrollin e mjeteve të transportit interurban, lidhur me verifikimin e mallrave që dyshohen për aktivitet tregtar dhe që nuk justifikohen me dokumentacion, kryesisht pranë degëve doganore në kufi, me pëlqim të administratës tjetër, të lejojë zyrtarë të saj të jenë prezent gjatë hetimit të shkeljeve kundër legjislacionit tatimor dhe doganor.
4. Në këtë rast pala kërkuese, njofton palën tjetër, e cila nëse e gjykon të nevojshme që në të njëjtën periudhë të kryejë hetim në të njëjtin territor, njofton brenda 7 ditësh kalendarike palën që i ka derguar njoftimin sipas rastit. Rolin koordinues dhe kryesues për këto kontrolle e ka Pala, e cila inicion këtë procedurë.

5. Në përfundim të hetimeve të pavarura ose të përbashkëta, kur palët konstatojnë shkelje, të cilat kanë pasoja në llogaritjen e detyrimeve tatimore, doganore ose të tjera, përveç se njoftojnë respektivisht njëra-tjetrën mbi rezultatet e kontrollit, nxjerrin akte të veçanta në përputhje me legjislacionin e fushës së administruar nga Pala.

Neni 6

Mbledhja e detyrimeve të papaguara dhe të tjera

1. **DPD**, menjëherë sapo të marrë njoftimin për bllokimin e aktivitetit nga DPT, dërgon punonjësit e saj në Drejtorinë Rajonale Tatimore, ku është kryer bllokimi, në përputhje me pikën 5(a) (iv), të nenit 3, të njihen me gjendjen reale dhe brenda 24 orësh fillon procedura e parashikuar në legjislacionin doganor për këtë qëllim.
2. **DPT**, menjëherë sapo të marrë njoftimin për bllokimin e mallit për qarkullim të lirë nga DPD, dërgon punonjësit e saj në Degën Doganore, ku është kryer bllokimi në përputhje me pikën 5(b) (ii)-(iii), të nenit 3, dhe brenda 24 orësh nga punonjësit tatimor nxirret urdhëri për sekuestrimin e mallit dhe dërgimit në ambiente të përshtatshme për të vijuar procedurat e mëtejshme.
3. Pala, në përputhje me pikën 5(a) (iv) dhe pikën 5(b) (ii)-(iii), të nenit 3, respektivisht, marrin masa për të mos lejuar regjistrimin e subjekteve debitoare.
4. Në kuadër të bashkëpunimit ndërinstitucional, në çdo moment Palët mund të formojnë një grup pune për hartimin e një strategjie të përbashkët dhe planeve të veprimeve për përmirësimin e situatës në mbledhjen e detyrimeve doganore dhe tatimore të papaguara.
5. Palët hartojnë dhe bashkërendojnë programe pune për kryerjen e veprimeve të përbashkëta në përputhje me procedurat ligjore për mbledhjen e borxhit. Programet e veprimeve të përbashkëta dhe punonjësit që do të kryejnë këto veprime autorizohen/miratohen nga titullarët e Palëve. Përveç sa është parashikuar në pikën 2 më sipër veprimet e përbashkëta të kryera në bashkëpunim për mbledhjen e borxhit doganor ose tatimor, këto veprime përfshijnë gjithashtu bllokimin e kryerjes së veprimtarisë ekonomike nga tatimpaguesit që rezultojnë debitorë në administratën tatimore apo doganore dhe për të cilët ka filluar procedurat për mbledhjen me forcë të detyrimeve sipas legjislacionit tatimor/doganor në fuqi, deri në përmbushjen e këtyre detyrimeve.
6. Të gjitha Drejtoritë Rajonale, për të gjithë subjektet të cilët kanë përmbushur kushtet për pezullimin e aktivitetit ekonomik në dogana, ditën e fundit të çdo jave duhet të nisin me format elektronike kërkesën pranë Drejtorisë së Mbledhjes me Forcë në DPT.
Nga ana e saj, Drejtoria e Mbledhjes me Forcë në DPT ditën e parë të javës duhet të nisi me format elektronike pranë DPD-së, kërkesën për pezullimin e aktivitetit ekonomik të tatimpaguesve sipas listës së nisur me email nga ana e Drejtorive Rajonale. Çdo Drejtori Rajonale, në çdo moment që i lind e drejta për lirimin e bllokimit të aktivitetit ekonomik në doganë për tatimpaguesin ndaj të cilit më parë është marrë masa e bllokimit, dërgon me email kërkesën për lirimin e bllokimit pranë Drejtorisë së Mbledhjes me Forcë në DPT. Nga ana e saj Drejtoria e Mbledhjes me Forcë në DPT, pasi verifikon kërkesën e Drejtorisë Rajonale dërgon me email pranë Drejtorisë së Përgjithshme të Doganave kërkesën për lirimin nga pezullimi i aktivitetit ekonomik në doganë.
7. Të gjitha Degët Doganore, për të gjithë subjektet të cilët kanë përmbushur kushtet për pezullimin e aktivitetit ekonomik në tatime, menjëherë sapo të merret Urdhëri i Ekzekutimit nga Organet Gjyqësore duhet të nisin me format elektronik kërkesën pranë Sektorit të Monitorimit të Borxhit në DPD.
Nga ana e tij, Sektori i Monitorimit të Borxhit në DPD, menjëherë duhet të nisi me format elektronik pranë Drejtorisë së Mbledhjes me Forcë në DPT, kërkesën për pezullimin e aktivitetit ekonomik të subjektit debitor. Çdo Degë Doganore, në çdo moment që i lind e drejta për lirimin e bllokimit të aktivitetit ekonomik në tatime, për debitorin ndaj të cilit më parë është marrë masa e bllokimit, dërgon me email kërkesën për lirimin e bllokimit pranë

Sektorit të Monitorimit të Borxhit në DPD. Nga ana e tij Sektori i Monitorimit të Borxhit në DPD, pasi verifikon kërkesën e Degës Doganore dërgon me email në Drejtorinë e Mbledhjes me Forcë pranë Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve kërkesën për lirim nga pezullimi i aktivitetit ekonomik në tatime.

Neni 7

Konfidencialiteti

1. Informacioni i shkëmbyer midis Palëve në kuadër të kësaj marrëveshje është konfidencial.
2. Palët dhe punonjësit e tyre, duhet të ruajnë konfidencialitetin e plotë të gjithë informacionit të përshkruar në këtë marrëveshje dhe të shkëmbyer midis tyre, në përputhje me dispozitat përkatëse legjislationin tatimor dhe doganor, që përcaktojnë konfidencialitetin dhe legjislationit në fuqi për mbrojtjen e të dhënave personale.
3. Pala, nuk duhet të publikojë materialet dhe informacionet e shkëmbyera midis tyre pa aprovim paraprak me shkrim nga Pala tjetër, me përjashtim kur janë të detyruara nga ligji.

Neni 8

Ndryshimi dhe Zgjidhja e Mosmarrëveshjeve

1. Ndryshimet e akteve ligjore e nënligjore, mbi të cilat bazohet kjo marrëveshje zbatohen automatikisht. Marrëveshja e Bashkëpunimit, si dhe anekset bashkëlidhur saj si pjesë integrale, mund të ndryshohet apo shtohet vetëm me miratimin me shkrim të dy Palëve. Në këtë rast, pala iniciuese njoftohet nga pala tjetër për rënien ose jo dakord me propozimin, brenda 30 ditëve prej marrjes së tij.
2. Format e bashkëpunimit të përmendura në nenin 2 të kësaj marrëveshje, në varësi të problematikave që mund të hasen gjatë zbatimit të saj, mund të përmirësohen apo plotësohen nga palët.
3. Mosmarrëveshjet që mund të lindin gjatë zbatimit të kësaj marrëveshjeje zgjidhen me mirëkuptim. Në rast të kundërt, Ministri i Financave dhe Ekonomisë është organi kompetent për zgjidhjen e tyre.
4. Përfaqësues të Palëve në nivel Zv/Drejtori të Përgjithshëm, organizojnë takime të përbashkëta, një herë në 3 muaj për të verifikuar zbatimin korrekt të marrëveshjes. Këto takime mundet të jenë edhe më të shpeshta në nivel teknik.

Neni 9

Hyrja në fuqi dhe kohëzgjatja

1. Kjo Marrëveshje Bashkëpunimi hartohet në gjuhën Shqipe, në 4 (katër) akte origjinale, 2 (dy) për Drejtorinë e Përgjithshme të Doganave dhe 2 (dy) për Drejtorinë e Përgjithshme të Tatimeve dhe nënshkruhet rregullisht nga titullarët e tyre.
2. Marrëveshja Bashkëpunimit hyn në fuqi menjëherë pas nënshkrimit nga palët dhe nuk ka kufizim në kohëzgjatjen e saj. Brenda një periudhe kohore prej tre muajsh nga nënshkrimi, Palët përmes takimeve në nivel teknik specifikojnë dhe qartësojnë çdo detaj për zbatimin e kësaj Marrëveshjeje.

Marrëveshja me Nr. 2669 Prot., datë 04.02.2015, e Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve dhe Nr. 2995 Prot., datë 04.02.2015, e Drejtorisë së Përgjithshme të Doganave, dhe çdo akt administrativ që lidhet me të shfuqizohet.

Kjo Marrëveshje Bashkëpunimi publikohet nga Palët në faqet zyrtare të internetit.

**PËR
DREJTORINË E PËRGJITHSHME TË
DOGANAVE**

DREJTORI PËRGJITHSHËM

Belinda Ikonomi



**PËR
DREJTORINË E PËRGJITHSHME TË
TATIMEVE**

DREJTORI PËRGJITHSHËM

Vasilika Vjero

